

**VENDIM**  
**NR.294, datë 26.1.1997**

Kuvendi Popullor i Republikës së Shqipërisë, duke diskutuar me përgjegjësi të lartë kombëtare e ligjore, duke parë e vlerësuar situatën e jashtëzakonshme, e cila po shkon në shkallëzim të mëtejshëm, nisur edhe nga informacionet e Ministrit të Brendshëm,

**VENDOSI:**

1.T'i kërkojë Komandantit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura që të angazhojë përkohësisht njësi të kufizuara të ushtrisë për të mbrojtur institucionet shtetërore e publike, si dhe lëvizjen e lirë në rrugët kombëtare.

II. Ky vendim hyn në fuqi më datë 26.1.1997